



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 nëntor 2017  
Nr. ref.: RK 1150/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI63/17

Parashtrues

**Lutfi Dervishi**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Kzz. 19/2017, të 11 prillit 2017

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Surøy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Lutfi Dervishi nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Valon Hasani, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kérkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Pml. Kzz. 19/2017] të 11 prillit 2017, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kérkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) [PNI 44/17] të 19 janarit 2017 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) [PKR. nr. 11. 2017] të 11 janarit 2017, për caktimin e paraburgimit për parashtruesin e kérkesës.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes së kérkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kérkesës të garantuara me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kérkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridikzioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kérkesës] dhe 47 [Kérkesa Individuale] të Ligjit për Gjykaten Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 (Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykaten Kushtetuese**

5. Më 1 qershor 2017, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykaten Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 2 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gérxhaliu-Krasniqi.
7. Më 6 qershor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës dhe i kérkoi që t'i dorëzojë Gjykatës: 1) autorizimin përfaqësuesin e tij para Gjykatës, dhe 2) kopjen e plotë të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [PNI 44/17] të 19 janarit 2017, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Pml. 19/2017] të 11 prillit 2017. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kérkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 14 qershor 2017, parashtruesi i kérkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet shtesë të kérkuara nga Gjykata.
9. Më 13 korrik 2017, parashtruesi i kérkesës kérkoi nga Gjykata që kérkesa e tij të shqyrtohet me urgjencë.

10. Më 30 gusht 2017, parashtruesi korrigjoi kérkesën sa i pérket disa lëshimeve teknike në datat e përshkruara në disa pjesë të kérkesës.
11. Më 18 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi reportin e gjyqtarit reportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

### **Përbledhja e fakteve**

12. Më 15 tetor 2010, kundër parashtruesit të kérkesës dhe disa personave të tjerë, ishte ngritur Aktakuza [PPS nr. 41/09], e cila është ndryshuar më 22 mars dhe 17 prill 2013, për veprat penale të parapara në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), si në vijim: trafikim me njerëz në bashkëkryerje sipas neneve 23 dhe 139; krim i organizuar sipas nenit 274; ushtrim i kundërligjshëm i veprimitarisë mjekësore sipas nenit 221; lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje sipas neneve 23 dhe 154; mashtrim sipas nenit 261; dhe falsifikim të dokumenteve sipas nenit 332.
13. Më 29 prill 2013, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. 309/10, P340/10] shpalli parashtruesin e kérkesës fajtor për kryerjen e veprave penale: trafikim me njerëz në bashkëkryerje dhe krim i organizuar, duke shqiptuar dënim me burgim prej 8 (tetë) vjetësh dhe dënim me gjobë në shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) euro.
14. Më 25 nëntor 2013, Gjykata Themelore lëshoi Urdhrin [P. nr. 309/10, 340/10] për mbylljen dhe konfiskimin e klinikës “Medikus”, pronar i së cilës ishte parashtruesi i kérkesës.
15. Parashtruesi i kérkesës dhe Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Prokurori), ushtruan ankesë kundër Aktgjykimit [P. 309/10 dhe P. 340/10] të Gjykatës Themelore dhe Urdhrit [P. nr. 309/10, 340/10] për konfiskimin e klinikës “Medikus”.
16. Më 6 nëntor 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR 52/14] aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kérkesës, dhe atë sa i pérket vërtetimit të gjendjes faktike, në lidhje me numrin e transplantimeve të veshkave në të cilat kishte marrë pjesë parashtruesi i kérkesës, duke ulur këtë numër nga 24 në 7, ndërsa konfirmoj vendimin mbi dënimin, siç ishte caktuar nga Gjykata Themelore. Ankesa e Prokurorit u refuzua, për aq sa i takonte parashtruesit të kérkesës.
17. Më 15 mars 2016, parashtruesi i kérkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR 52/14] në Gjykatën Supreme, në bazë të nenit 430 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK) që mundëson ankesën kundër aktgjykimit, në rast se gjykata e shkallës së dytë vërteton ndryshe gjendjen faktike.
18. Më 17 mars 2016, Kryetari Gjykatës Themelore lëshoi Urdhrin [ED. nr. 252/2016] për fillimin e vuajtjes së dënitit ndaj parashtruesit të kérkesës.

19. Më 5 prill 2016, parashtruesi i kërkesës, paraqiti edhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PAKR 52/14] të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjithashtu bëri kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përderisa të vendoset për ankesat përkatëse. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, ankesë paraqiti edhe Prokurori.
20. Më 26 prill 2016, Gjkata Supreme përmes Aktvendimit [PML-KZZ-92/2016] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit derisa të vendoset për kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë.
21. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk u paraqit për vuajtje të dënitit sipas Urdhrit [ED. nr. 252/2016] të Kryetarit të Gjykatës Themelore.
22. Më 15 dhjetor 2016, Gjkata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. Kzz. 92/2016], gjeti se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, ishte pjesërisht e bazuar. Gjkata Supreme urdhëroi pushimin e menjëhershëm të zbatimit të Aktgjykimit [PAKR 52/14] të Gjykatës së Apelit dhe atij të Gjykatës Themelore [P. 309/10 dhe P340/10] dhe ktheu rastin e parashtruesit të kërkesës në rivendosje në Gjykatën Themelore. Gjkata Supreme arsyetoi, se procedura që i ka paraprirë Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PAKR 52/14] është përfshirë në shkelje esenciale të procedurës penale për shkak se, në mes tjerash, Kryetari i trupit gjykues do të duhej të përjashtohej nga pjesëmarrja në shqyrtim, por ai ka marrë pjesë në të.
23. Më 6 janar 2017, Prokurori paraqiti para Gjykatës Themelore kërkesën për urdhërarrest ndaj parashtruesit të kërkesës.
24. Më 10 janar 2017, Gjkata Themelore nxori urdhërarrest për parashtruesin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës u arrestua.
25. Më 11 janar 2017, Prokurori kerkoi nga Gjkata Themelore që të vendosë masën e paraburgimit për parashtruesin e kërkesës.
26. Më 11 janar 2017, Gjkata Themelore përmes Aktvendimit [PKR. nr. 11/2017] aprovoi kërkesën e Prokurorit për vendosje të paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës dhe caktoi paraburgimin në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji.
27. Më 13 janar 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj Aktvendimit [PKR. nr. 11/2017] të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Ndërsa, më 16 janar 2017, Prokurori parashtroi përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës.
28. Më 19 janar 2017, Gjkata e Apelit përmes Aktvendimit [PN1 44/17] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.
29. Më 30 janar 2017, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër arrestit dhe paraburgimit, për shkak të “shkeljeve

*esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të të drejtave të njeriut.”*

30. Më 11 prill 2017, Gjykata e Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. Kzz. 19/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore dhe të Apelit.
31. Më 9 shkurt 2017, Gjykata Themelore vazhdoi masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës për dy muaj, ndërsa më 10 prill 2017, Gjykata Themelore vazhdoi masën e paraburgimit edhe për dy muaj të tjerë.
32. Më 14 shkurt 2017, Prokurori paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ndaj Aktgjykimit [Pml. Kzz. 92/2016] të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se Gjykata Supreme kishte vendosur kundërligjshëm për mbrojtje të ligjshmërisë pa vendosur në lidhje me ankesën e ngritur në bazë të nenit 430 të KPPPK-së kundër Aktgjykimit [PAKR 52/14] të Gjykatës së Apelit, të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Pml. Kzz. 19/2017] i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
34. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 29, parashtruesi i kërkesës pretendon se arrestimi i tij nga policia është bërë më 10 janar 2017, në ora 10:00, duke u bazuar në urdhërarrest të lëshuar në bazë të vendimeve të “*cilat ishin anuluar nga [...] Gjykata Supreme*” me Aktgjykimin [Pml. Kzz. 92/2016], e Gjykatës Supreme, përmes të cilit rasti i parashtruesit të kërkesës u rikthye në rigjykim. Parashtruesi pretendon që vetëm pasi parashtruesi i kërkesës ishte arrestuar, Gjykata Themelore ka lëshuar urdhërarrest të ri, në të cilin nuk specifikohet ora e lëshimit.
35. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu konsideron se arrestimi i tij nuk ka bazë ligjore në Kodin e Procedurës Penale dhe shkel të drejtën e tij për liri dhe siguri, pasi “*e vetmja arsyё legitime dhe ligjore për lëshimin e urdhërarrestit [...] do të ishte nëse i pandehuri nuk do të respektonte detyrimin e tij ligor për t'u paraqitur në seancat që do të caktoheshin nga ana e Gjykatës Themelore*”. Parashtruesi po ashtu pretendon që gjykatat e rregullta nuk kanë “*përdorur masën adekuate për të siguruar [parashtruesin] në procedurë - përmes dërgimit të ftesës - por në mënyrë automatike e ka privuar atë*”.
36. Parashtruesi i kërkesës, më tej, specifikon në lidhje me të drejtën për liri dhe siguri se “[n]ë mënyrë që të respektohen kërkesat e ligjshmërisë së privimit nga liria, paraburgimi duhet të jetë në përputhje me procedurën e paraparë” të legjislacionit vendor. Në lidhje me këtë, parashtruesi i referohet rastit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), Aktgjykimit të 21 tetorit 2013 *Del Rio Prada* kundër *Spanjës*, nr. 15/1997/799/1002.

37. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke theksuar se “[Gjykatat e rregullta, në të tri nivelet ose nuk kanë dhënë fare arsyetim lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të të pandehurit ose arsyetimi i dhënë nuk është adekuat”. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës referohet Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 2 tetorit 2014, *Hansen kundër Norvegjisë*, nr. 15319/09.
38. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta aprovojë kërkesën si të pranueshme; të konstatojë shkelje të paragrafit 1 dhe 4 të nenit 29 dhe paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës; dhe, të shpallë të pavlefshme vendimet e gjykatave të rregullta, përcaktësish Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML. Kzz. 19/2017], Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [PN1 44/17] dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore [PKR. nr. 11/2017], lidhur me paraburgimin e tij.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

39. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe më tej të parapara në Ligj dhe të përcaktuara në Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiuni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
 

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
41. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 48  
Saktësimi i Kërkesës*

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

*Neni 49  
Afatet*

*“Kërkesa parashtronhet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

42. Për sa i përket përbushjes së këtyre kérkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kérkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [PML. Kzz. 19/2017] të 11 prillit 2017, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kérkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kérkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kérkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
43. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kérkesës ka përbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 36 (1) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kérkesën, duke përfshirë kriterin që kérkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifisht, rregulli 36 përcakton që:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kérkesë nëse:*

[...]

*(d) kérkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kérkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

*d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

[...]

44. Gjykata rikujton se parashtruesi i kérkesës pretendon shkelje të paragrafëve 1 dhe 4 të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, pasi konsideron se: *i)* arrestimi dhe mbajtja e tij është bërë pa bazë ligjore për arsy se urdhër arresti është nxjerrë pas arrestimit të tij; dhe *ii)* nuk janë përbushur kriteret ligjore në bazë të legjislacionit të aplikueshëm për të vendosur masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kérkesës. Parashtruesi i kérkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], pasi konsideron se: *iii)* gjykimi i tij ishte i anshëm duke shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës; dhe *iv)* vendimet e gjykatave të rregullta në lidhje me paraburgimin e tij nuk janë të arsyetuara mjaftueshëm.

### **Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të Konventës**

45. Gjykata fillimisht rikujton nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës, që përcaktojnë:

Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] i Kushtetutës:

“1. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

[...]

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

[...]

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kuption. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përparrë gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

[...]

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet liri i personit.”

Neni 5 (E Drejta për Liri dhe Siguri) i Konventës:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

[...]

c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përparrë autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsyë të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

[...]

*2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet.*

*3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij nenit, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjyket brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet nga garanci për t'u paraqitur para gjykatës.*

*4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.”*

[...]

46. Përbajtja e nenit 5 të Konventës dhe zbatimi i tij, janë interpretuar në mënyrë të detajuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën, Gjykata sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave të Drejtave të Njeriut] duhet të bëj interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të Konventës, Gjykata ka referencë një praktikë të zhvilluar gjyqësore të GJEDNJ-së.
47. Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja ka trajtuar dhe sqaruar rëndësinë e të drejtës përliri dhe siguri në shoqërinë demokratike, raportet me parimin e sigurisë juridike dhe sundimin e ligjit, duke specifikuar se qëllimi i përgjithshëm i të drejtës përliri dhe siguri është që të sigurohet që askujt nuk mund t'i kufizohet liria në mënyrë arbitrale. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2013, *El-Masri kundër ish-Republikës Juogosllave të Maqedonisë*, nr. 39630/09, parografi 230).
48. Në këtë aspekt, dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata thekson se në bazë të nenit 29 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të Konventës, secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë, me përjashtim të rasteve kur privimi nga liria bëhet mbi bazat e përcaktuara me këto nene, duke e ndjekur procedurën e paraparë me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente. Sërisht, qëllimi i këtyre neneve është të sigurohet që askush nuk privohet nga liria në mënyrë arbitrale. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 8 qershorit 1976 *Engel and others kundër Holandës*, nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72, parografi 58).
49. Gjykata me tej thekson që edhe nenit 29 i Kushtetutës dhe nenit 5 i Konventës, përpos garancive, përcaktojnë edhe përjashtimet përkatëse, të specifikuara me nenit 29 të Kushtetutës, parografi 1, nënparagrafët 1 deri në 5 dhe nenit 5 të Konventës parografi 1, nënparagrafët a deri në f, mbi bazën e të cilave mund të bëhet privimi i lirisë, gjithnjë në bazë të procedurës se përcaktuar me ligj dhe në respektim të të drejtave të garantuara me nenit 29 të Kushtetutës, paragrafët 2 deri në 6, dhe nenit 5 të Konventës, paragrafët 2 deri në 5.

50. Në këtë aspekt, GJEDNJ ka sqaruar se lista e përjashtimeve sa i përket të drejtës pér liri dhe siguri, është një listë e mbyllur dhe vetëm interpretimi i ngushtë i këtyre përjashtimeve mund të jetë konsistent me qëllimet e nenit 5. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 marsit 1995 *Qunn kundër Francës*, nr. 18580/91, paragrafi 42).
51. Rrjedhimisht, dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, privimi i lirisë mund të bëhet vetëm duke respektuar garancitë substanciale dhe procedurale të përcaktuara me nenin 29. 1 (1-5) të Kushtetutës në lidhje me nenin 5. 1 (a-f) të Konventës dhe, duke respektuar të drejtat e garantuara me nenin 29 (2-6) të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (2-5) të Konventës. Këto të fundit përfaqësojnë “*një korpus të të drejtave përbajtjësore që kanë pér qëllim të minimizojnë rrezikun e arbitraritetit duke mundësuar që akti përmes të cilës është bërë heqja e lirisë të shqyrtohet nga një gjyqësor i pavarur dhe duke mundësuar llogaridhënien e autoriteteve të cilat e kanë ndërmarrë këtë veprim*”. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 25 majit 1998 *Kurt kundër Turqisë*, nr. 15/1997/799/1002, paragrafi 123).
52. Më tej, Gjykata sqaron që, në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, dy parime kryesore duhet të merren parasysh në interpretimin e të drejtës së lirisë dhe sigurisë, “parimi i ligjshmërisë” dhe ai i “mbrojtjes nga arbitrariteti”.
53. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson praktikën GJEDNJ që ka sqaruar se, “parimi i ligjshmërisë” në kuptimin e nenit 5, përmban ndjekjen e procedurës së përcaktuar në ligj. Shprehja “e ligjshmë” dhe “në pajtueshmëri me legjislacionin vendor” e përdorur në nenin 5 (1) të Konventës dhe nenin 29 (1) të Kushtetutës, i referohet legjislacionit të aplikueshëm vendor dhe nënkupton obligimin pér të respektuar rregullat materiale dhe procedurale të këtij legjislacioni. Edhe pse, së pari është obligim i gjykatave të rregullta pér të interpretuar dhe aplikuar legjislacionin përkatës, në bazë të nenit 5 (1) të Konventës dhe nenin 29 (1) të Kushtetutës, dështimi pér të respektuar legjislacionin vendor sa i përket kufizimit të lirisë dhe sigurisë, nënkupton shkelje të Konventës dhe Gjykata mund dhe duhet të rishikoj nëse legjislacioni është respektuar. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së *Del Rio Prada kundër Spanjës*, paragrafi 125; dhe, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 marsit 1995 *Ladent kundër Polonisë*, nr. 11036/03, paragrafi 47).
54. Pér më tepër, periudha e arrestimit është parimisht “e ligjshmë” nëse është e bazuar në Urdhër nga Gjykata, ndërsa gabimet e mundshme në lidhje me urdhërarestin jo domosdoshmërisht nënkuptojnë se periudha e caktuar e mbajtjes ka qenë e paligjshme nga pikëpamja e nenit 5 (1) të Konventës. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së *Ladent kundër Polonisë*, paragrafi 47).
55. “Parimi i ligjshmërisë” në kuptimin e nenit 5 të Konventës, nënkupton edhe mungesën apo mbrojtjen nga arbitrariteti. Në këtë aspekt, respektimi i legjislacionit vendor, nuk është megjithatë i mjaftueshëm. Neni 5 (1) i Konventës në lidhje me nenin 29 (1) të Kushtetutës kërkojnë, pér më tepër, që çdo heqje e lirisë duhet të respektoj qëllimin e mbrojtjes nga arbitrariteti.

(Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Ladent kundër Polonisë* paragafi 48).

56. Për më tepër, GJEDNJ ka një praktikë të pasur gjyqësore, edhe sa i përket përjashtimeve mbi të cilat mund të bëhet privimi i lirisë, në raport me të drejtat edhe parimet përkatëse. Për qëllime të rastit në fjalë, Gjykata vëren, se në bazë të nenit 29.1 (2) të Kushtetutës dhe nenit 5. 1 (c) të Konventës, privimi i lirisë mund të bëhet në rast të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale, dhe një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale ose largimin pas kryerjes së saj. Privimi i tillë i lirisë, sipas neneve përkatëse, duhet të bëhet duke respektuar procedurën e përcaktuar me ligj, dhe duhet t'i garantojë të drejtat shtesë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Konventë.
57. Në këtë aspekt, neni 29.1.2 i Kushtetutës në lidhje me nenin 5.1.c të Konventës, përcaktojnë bazat mbi të cilat mund të bëhet arrestimi apo privimi i lirisë gjatë procesit të administrimit të drejtësisë penale. GJENDJ, në praktikën e saj gjyqësore, ka përcaktuar tri çështje themelore, që duhet ekzaminuar për të vlerësuar nëse ky arrestim ose privim i lirisë, është i ligjshëm dhe joarbitrar: 1) “vepra penale”, term ky që për qëllime të nenit 5 të Konventës është interpretuar në Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 29 nëntorit 1988, *Brogan kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 11209/84, 11234/84; 11266/84; 11386/85), dhe që në parim, përfshinë një vepër të përcaktuar si penale në ligjin vendor (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 1989, *Ciulla kundër Italisë*, nr. 11152/84, paragafi 38); 2) “Qëllimin e Privimit”, që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 7 marsit 2013, *Ostendorf kundër Gjermanisë*, nr. 15598/08, paragafi 68), dhe që për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 18 qershorit 2008, *Ladent kundër Polonisë*, nr. 11036/03, paragafi 55); dhe, 3) “Dyshimi i bazuar”, rrjedhimisht, dyshimi i bazuar në fakte të arsyeshme që në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, “përbën esencën sigurisë kundër arrestimit apo privimit të lirisë në mënyrë arbitrale”. (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 30 gushtit 1990 *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 12244/86; 12245/86, 12383/86, paragafi 32).
58. Më specifisht, në mënyrë që arrestimi të jetë i ligjshëm, duhet të ekzistojnë ‘dyshimi i bazuar’ se i dyshuari ka kryer veprën penale dhe “të gjitha rrëthanat duhet të bindin një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale”. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 30 gushtit 1990, *Fox Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 12244/86, 12245/86, 12383/86).
59. Duke aplikuar parimet kryesore të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, për aq sa janë të përshtatshme për rastin në fjalë dhe siç janë elaboruar më lart, më tej, Gjykata do të shqyrtoj nëse Kushtetuta, Konventa dhe kriteret e elaboruara, janë respektuar në rastin e parashtruesit të kërkesës.
60. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe Konventën, arrestimi ose paraburgimi, duhet të ketë mbështetje në njërin

nga bazat për privimin e lirisë të përcaktuara me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të Konventës; që arrestimi apo paraburgimi, të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar në ligj, duke përbushur kushtin e “parimit e ligjshmërisë” dhe “mbrotjes nga arbitrariteti”; dhe në fund, në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet që vepra të jetë e kualifikuar si penale, duhet të ekzistoj qëllimi i arrestit ose privimit të lirisë, dhe, duhet të ekzistoj “dyshimi i bazuar”.

61. Gjykata rithekson që arrestimi në rastin në fjalë, është i bazuar në nenin 29.1.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5.1.c të Konventës. Ndërsa, sa i përket pretendimeve që arrestimi në fjalë, nuk është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligj dhe është bërë në mënyrë arbitrale, kritere këto të përcaktuara në Kushtetutë, Konventë dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata vëren:
62. Së pari, në lidhje me pretendimin se arrestimi dhe mbajtja e parashtruesit të kérkesës është bërë pa bazë ligjore, Gjykata thekson se në fakt, privimi nga liria i parashtruesit të kérkesës nuk është bërë në bazë të Urdhrit [ED. nr. 252/2016] të 17 marsit 2016, që më pas u anulua me Aktgjykimin [Pml. KZZ. 92/2016] e Gjykatës Supreme, por është bërë në bazë të urdhërarrëstit të 10 janarit 2017, të lëshuar nga Gjykata Themelore, pas kérkesës së Prokurorit të bërë më 6 janar 2017.
63. Ndërsa, në lidhje me pretendimin se urdhërarrësti i 10 janarit 2017, ishte lëshuar vetëm pas arrestimit të parashtruesit të kérkesës me po të njëjtën datë, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka paraqitur fakte të mjaftueshme për të mbështetur një pretendim të tillë.
64. Në këtë aspekt, dhe për më tepër, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur për juridikcionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kérkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
65. Së dyti, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kérkesës, që arrestimi i tij nuk është bërë duke e ndjekur procedurën e përcaktuar në KPKK, Gjykata vëren, që parashtruesi i kérkesës është sjellë para gjykatës përkatëse të nesërmën e arrestit, ku me Aktvendimin [PKR. nr. 11/2017] të Gjykatës Themelore, i ishte caktuar paraburgimi. Aktvendimi i Gjykatës Themelore, ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit edhe nga Gjykata Supreme.

66. Për më tepër, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme [Aktgjykimi Pml. Kzz 19/2017] arsyetoj vendimin e saj për refuzimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës për arrestim të paligjshëm, duke specifikuar se “*privimi nga liria i [parashtruesit] në të vërtetë është i ligjshëm pasi që ai ishte arrestuar me 10 janar 2017 dhe menjëherë ishte sjellë para gjykatës bazuar në urdhëarrestin e nxjerrë në po të njëjtën ditë*”.
67. Nga këto vendime përkatëse të gjykatave të rregullta është e qartë se ka pasur bazë ligjore për ta mbajtur parashtruesin e kërkesës në paraburgim dhe se Gjykata nuk ka gjetur që ka pasur shkelje të procedurës në bazë të legjislacionit në fuqi apo që procedurat kanë qenë në ndonjë mënyrë arbitrale.
68. Gjykata gjithashtu rikujton se KPPK-ja, përkatësisht neni 187 i saj, përcakton procedurën për caktimin e masës së paraburgimit, duke përfshirë provat e nevojshme që mbështesin “dyshimin e bazuar”, se personi i arrestuar ka kryer veprën penale, dhe përshkrimin e kushteve që mbështesin bazat e artikulueshme për të besuar, për aq sa është e nevojshme në rastin specifik, se: 1) ka rrezik të arratisjes; dhe 2) masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të pamjaftueshme.
69. Gjykata thekson, që vendimet e gjykatave të rregullta përbajnjë arsyetimet e nevojshme për të gjitha kriteret e lartpërmendura, e relevante për rastin në fjalë. Gjykata rikujton se gjykatat e rregullta, kishin arsyetuar, ndër të tjera se 1) ekziston dyshimi i bazuar; dhe 2) ekziston rreziku i arratisjes.
70. Gjykata rikujton aktakuzën e cila është ngritur në bazë të “dyshimit të bazuar” për kryerjen e veprave penale me të cilat ngarkohet parashtruesi i kërkesës, dhe se ky parashtrues ishte dënuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, Aktgjykime këto që ishin anuluar nga Gjykata Supreme për arsyet e shkeljeve procedurale, duke e kthyer çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore. Në lidhje me këtë, “dyshimi i bazuar” për kryerjen të veprës penale nga parashtruesi ende ekziston.
71. Ndërsa, në lidhje me rrezikun e ikjes së parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme [Aktgjykimi Pml. Kzz 19/2017] se:

*“mosparaqitja e [parashtruesit] para institucionit korrektues bazuar në urdhrin e lëshuar më 25 mars 2016, madje edhe pasi kërkesa e tij për të ndalur ekzekutimin e dënimit të shqiptuar ishte refuzuar, tregon qartë rrezikun e ikjes. [...] Fakti se [parashtruesi] nuk ka vepruar në përputhje me këta urdhra dhe është shmangur, tregon qartë qëndrimin dhe respektin ndaj detyrimeve të tij që dalin nga vendimet e gjykatave. Si rrjedhojë, [Gjykata Supreme] refuzon pretendimet se rreziku i ikjes nuk ekziston. [...] Aktvendimet e [Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit] përfshijnë shpjegime të gjithashme të të gjitha faktave materiale që përbëjnë bazat për aktvendime, duke përfshirë arsyet për dyshimin e bazuar se [parashtruesi] ka kryer veprat penale me të cilat ai ngarkohet, vërtetimin e rrezikut të ikjes dhe mundësinë e zbatimit të një prej masave më të buta të parashikuara në KPP.”*

72. Në fund, Gjykata gjithashtu rikuhton edhe kriteret e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, sa i përket privimit të lirisë, të bërë mbi bazën e nenit 29.1.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5.1.c të Konventës, "kualifikimin e veprës si penale", "qëllimin e privimit", dhe "dyshimin e bazuar", respektivisht. Gjykata rithekson, që veprat për të cilat akuzohet parashtruesi i kërkesës janë të kualifikuara si penale në KPRK; që privimi nga liria në rastin e fjalës sështë bërë për qëllime të administrimit të drejtësisë penale; dhe që siç sështë elaboruar më lart, ekziston dyshimi i bazuar në këtë rast, që parashtruesi i kërkesës ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.
73. Sa i përket rastit të GJEDNJ-së *Del Rio Prada kundër Spanjës*, të cekur më lart, në të cilin thirret specifisht parashtruesi i kërkesës, duke argumentuar se paraburgimi duhet të jetë në përpjekje me procedurën e paraparë ligjore, Gjykata rithekson që në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ka sqaruar aplikueshmërinë e "parimit të ligjshmërisë" në kuptimin e nenit 5 të Konventës në rrëthanat e rastit specifik, dhe për më tepër, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar mjaftueshmë që gjykatat e rregullta kanë cenuar kriteret e vendosura në rastin e cekur më lart.
74. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta ishin të arsyetuara dhe të drejta kur kishin vendosur për çështjen e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, prandaj, nuk mund të thuhet se nuk kanë qenë të arsyetuara në pajtim me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të Konventës apo që, shikuar në tërësinë e tyre, kanë qenë në ndonjë mënyrë arbitrale. (shih: *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 14 qershorit 2016 *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 72508/13, paragrafi 87).

### **Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës**

75. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, sepse gjykimi nuk ishte i paanshëm dhe se vendimet e gjykatave nuk kanë qenë të arsyetuara, Gjykata, së pari, rikuhton se sa i përket arsyetimit të vendimeve, Gjykata i ka trajtuar ato pretendime kur ka vlerësuar shkeljet e pretenduara në lidhje me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të Konventës, duke vlerësuar se ato i plotësojnë kriteret e parapara për të drejtën përliri dhe siguri.
76. Gjykata rikuhton se parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet tjera, sa i përket shkeljes së nenit 31 [E Drejta përgjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
77. Për më tepër, Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së ka sqaruar se nenit 5, paragrafi 4 i Konventës, përmban garanci specifike procedurale sa i përket kufizimit të lirisë që janë të ndara nga garancitë procedurale të nenit 6 të Konventës, sa i përket të drejtës përgjykim të drejtë. Për këtë arsy, nenit 5 paragrafi 4 i Konventës, sështë *lex specialis* në raport me nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do t'i shqyrtoj ndaras shkeljet e pretenduara në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës. (Shih *mutatis mutandis*, Aktgjykim i GJEDNJ-së të 15 nëntorit 2005 *Reinprecht kundër Austrisë*, nr. 67175/01, paragrafi 55).

78. Gjykata në fund thekson se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen kushtetuese e të drejtës së tij për liri dhe siguri, dhe se parashtruesi nuk ka paraqitur fakte që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta ishin në ndonjë mënyrë shkelje e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 18 tetor 2017, njëzëri

## VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

  
Gresa Caka-Nimani

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
  
Arta Rama-Hajrizi